



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përhëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për arsye objektive sot nuk është prezent Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami dhe mbledhjen do ta drejtoj unë, Zëvendëskryetar Ilir Rusi. Gjithashtu, për arsye objektive nuk është prezent në këtë mbledhje edhe zonja Luli.

Për shkak të krijimit të kuorumit, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e rendit të ditës, natyrisht që fillohet, me nëse kanë diskutime mbi rendin e ditës anëtarët dhe fjalën e ka kërkuar zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Duke qenë se në mbledhjen e datës 19 kam kërkuar shtyrjen e një pike të rendit të ditës që lidhet pikërisht me rregulloren për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, pikë e cila u shty me kërkesën time për t’u njohur me materialin që na u vu në

dispozicion nga zonja Ukperaj, unë kërkoj që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së sotshme, nëse edhe anëtarët do të votojnë dakord për përfshirjen e saj, referuar nenit 67 të ligjit për qeverisjen. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua nga zonja Shehu?

Atëherë, edhe një herë ftoj anëtarët e Këshillit të lartë Gjyqësor prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u parashtrua/propozua nga zonja Shehu.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim propozimin e zonjës Shehu për t'u përfshirë në rendin e ditës së sotme edhe një pikë që ka të bëjë me rregulloren për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Irena Plaku: Kundër, duke qenë se nuk jam njohur me këtë kërkesë më përpara.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Përfshihet në rendin e ditës edhe shqyrtimi i rregullores për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Ilir Rusi: Atëherë, vazhdojmë me rendin e ditës, përkatësisht me pikën 1 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Pa humbur kohë po vijoj me relacionin mbi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira, në fushën e të drejtës civile, respektivisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, brenda afateve respektive të kandidimit, kandiduan gjithsej 5 (pesë) kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe z. {...}.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë ose të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” si dhe kriterin e pasurisë dhe të figurës.

Gjatë procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit, për një kandidat Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për atë u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Bëhet fjalë për kandidatin z. {...} i cili me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Për 4 (katër) kandidatë të tjerë, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht:

1) Znj. {...}, ka kandiduar për dy pozicione të lira, me vendimet nr. 536, datë 17.11.2021 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. [...]

2) Znj. {...}, ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536, datë 17.11.2021 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021.

3) Z. {...}, ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536, datë 17.11.2021 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021.

4) Znj. {...}, ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536, datë 17.11.2021 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021.

Krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijoi edhe procedura e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2021, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar. Duhet përmendur se kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën

Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022 për vlerësimin etik dhe profesional të saj për vitin 2021. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 vendosi rrëzimin e kërkesë padisë. Si i tillë, vendimi nr. 537, datë 14.12.2022 konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Këshilli ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 14.12.2022 duke i propozuar Presidentit të Republikës dekretimin e znj. {...}. Në situatën si më lart, renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja me qëllim propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, mund të vijojë e të përmbyllet edhe për të dy pozicionet e lira të mbetura në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 536 dhe nr. 537.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 536 dhe nr. 537.

Kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537. Kjo kërkesë është rrëzuar dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

Ndaj vendimit nr. 536, datë 14.12.2022 nuk rezulton të jetë paraqitur ankim brenda afatit ligjor, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161, datë 06.04.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Sa më sipër rezulton nga deklarata e kandidatit, përmes komunikimit elektronik të datës 18.04.2023, në të cilën është shprehur dakordësia lidhur me vendimin. Lidhur me vendimin nr. 4, datë 16.01.2023, nuk rezulton të jetë paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit.

Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr.3, datë 16.01.2023. Këto vendime janë përfundimtarë, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur

ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 119, datë 15.03.2023 dhe nr. 230, datë 11.05.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë. Ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Gjatë procedurave së përzgjedhjes, kandidatja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative. Për këtë kandidate, në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, Këshilli, ka miratuar renditjen e kandidatëve me vendimin nr. 212, datë 28.04.2023, ku kandidatja znj. {...} rezulton e para në renditje. Më tej, Këshilli, me vendimin nr. 270, datë 25.05.2023 ka vendosur që znj. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Nisur nga një rrethanë e tillë, duke marrë në konsideratë faktin se Këshilli i ka përfunduar procedurat për ngritje në detyrë të kësaj kandidateje për pozicionin nr. 535, datë 17.11.2021 duke e propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli vlerëson se kandidimi i znj. {...} për pozicionet e tjera, duke përfshirë edhe pozicionin nr. 536, datë 17.11.2021 mbetet pa objekt.

Renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...} ({...}); z.{...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë: i) kualifikimi në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit; ii) kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Siç u përmend edhe më sipër në këtë relacion, kandidatja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021. Në këto kushte kandidimi i saj për pozicionin nr.536 mbetet pa objekt.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

Për z. {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 3, datë 16.01.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për znj. {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 230, datë 11.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 119, datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që një kandidate, konkretisht znj. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse dy kandidatët e tjerë, znj. {...} dhe z. {...} vlerësimin etik dhe profesional për periudhën e gradimit i kanë “Shkëlqyeshëm”, ndërsa vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar për vitin 2021 e kanë “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohen një kandidate me rezultate “Shkëlqyeshëm”, konkretisht kandidatja znj. {...}, e cila renditet më lart se kandidatët znj. {...} dhe z. {...}.

Referuar pikës 12, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: “12. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.”

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët e tjerë renditen pas saj. Meqenëse pas këtij hapi arrihet të përzgjidhet kandidati që renditet i pari referuar kritereve të nivelit të vlerësimit, vijimi i hapave të tjerë të renditjes për kandidatët e tjerë që janë znj. {...} dhe z. {...} është i panevojshëm.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...} dhe z. {...}.

Mbi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. {...}”.

Bazuar në sa përcaktohet më lart, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 21 të tij, por edhe të rrethanës sipas pikës 22, relatori administroi tërësisht dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përmbylljes së procedurës së përzgjedhjes sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536 datë 17.11.2021.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 230, datë 11.05.2023 dhe nr. 119, datë 15.03.2023 vendime të cilët janë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidates, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2840/4, datë 18.05.2023.

Mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes, mbështetur në nenet 136, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 12 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin Paraprak të Propozimit për Emërim nr. 315, datë 14.06.2023, vendosi:

Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...}; Z. {...}.

Më tej në vendimin paraprak është vendosur:

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidates znj. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim, iu njoftua rregullisht, kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Kandidatja znj. {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mësipërm, duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidatja znj. {...}, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 44, datë 14.07.2023 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Në këto kushte, vendimi paraprak i propozimit, ka marrë formë të prerë me datë 14.07.2023.

Deri më datë 24.07.2023 u kërkua informacion në rrugë elektronike nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë lidhur me faktin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit paraprak të propozimit për emërim të Këshillit, nga kandidatët tjerë z. {...} dhe znj. {...}.

Po më datë 24.07.2023, në rrugë elektronike, u konfirmua nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë lidhur me faktin e mosparaqitjes ankim ndaj vendimit paraprak të propozimit për emërim të Këshillit, nga dy kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 70, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin përfundimtar të propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates së renditur më lart, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021.

Projektvendimi titullohet “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit përmban propozimin për Presidentin e Republikës, të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidates znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paarsyetuar apo jo?

Klodian Kurushi: Po!

Marçela Shehu: Atëherë, unë nuk kam propozime apo kërkesa. Do të doja vetëm të ndaja qëndrimin tim në lidhje me këtë moment, me qëllim që të mbaj edhe të njëjtin standard me standardin që mbajta në momentin që u shqyrtua projektvendimi për propozimin për emërim të kandidates znj. {...}.

Siç relatova edhe në atë moment, do të vlerësoja si të përshtatshme që përpara se Këshilli të shqyrtonte dhe të miratonte projektvendimin e paraqitur, do duhej që të njiheshim me vendimin e arsyetuar të Gjykatës Administrative të Apelit që ka rrëzuar në këtë rast padinë e ngritur nga një prej kandidatëve, konkretisht nga znj. {...}.

Rezulton që edhe në këtë vendim të shkurtuar, një nga gjyqtarët është në pakicë, një nga gjyqtarët është kundër më duket në lidhje me rekursin, ndërsa një nga gjyqtarët është kundër. Gjithashtu do doja që përpara shqyrtimit të kishim edhe një informacion në lidhje me faktin nëse ndaj këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit është ushtruar rekursi nga ana e zonjës {...} apo jo.

Gjithsesi, ky është mendimi dhe qëndrimi im. Nuk është një propozim, sepse në momentin që Këshilli e shqyrtoi dhe e rrëzoi kërkesën e paraqitur nga unë në mbledhjen ku u shqyrtua projekt–propozimi për emërimin e zonjës {...}, mendoj që Këshilli e vendosi standardin dhe nuk ka më vend për të bërë një propozim dhe një votim. Gjithsesi, për të shprehur mendimin dhe standardin tim të njëjtë, unë doja ta ndaja mendimin tim me ju. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka ndonjë diskutim?

(Nuk ka diskutim.)

Meqenëse nuk ka diskutime, sikundër u theksua nga zonja Shehu, kjo është një parashtrësë e qëndrimit të saj të mbajtur në raste të mëparshme por nuk është një propozim, kështu që, meqenëse nuk ka diskutime, po kalojmë në votimin e projektvendimit të paraqitur nga Komisioni përkatës i zhvillimit të karrierës, i cili u relatua nga zoti Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidates znj. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020”, me relator znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Zonja {...} ka qenë gjyqtare e komanduar në ish-KLD dhe pastaj ka vijuar komandimin në KLGJ deri në datën 7.02.2020 ku ajo është komanduar më tej pranë ILD-së.

Projektraporti i vlerësimit që sot është për miratim në plenare lidhet me periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020 dhe hartohet bazuar në nenet 68, 89 e vijues të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin”, si dhe vendimit të KLGJ-së nr. 159, datë 05.04.2023

“Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Projektraporti i vlerësimit në rastin konkret nuk shoqërohet nga një raport analitik sepse të tillë e kemi miratuar procedurën e vlerësimit për gjyqtarët e komanduar.

Burimet e vlerësimit evidentohen në mënyrë kronologjike sipas datës së mbërritjes së tyre dhe të mbledhjes nga ana e relatorit në dosjen e vlerësimit.

Pjesa e parë e projektraportit shpjegon të gjithë procedurën e ndjekur nga ana e relatorit që me fillimin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, i cili ka filluar me vendimin nr. 174, datë 25.04.2023 dhe procedura përfundon deri në miratimin e plotësisë së dokumentacionit nga ana e komisionit dhe përcjelljen për shqyrtim në plenare.

Gjyqtarja është njoftuar për projektraportin e vlerësimit, është njoftuar me të dhënat e dosjes së saj të vlerësimit për arsye se korrespondenca dhe transparenca është e tillë që gjyqtari të njihet me të gjitha aktet që janë pjesë e dosjes së vlerësimit. Nuk ka paraqitur kundërshtime. Nuk ka bërë kërkesë për prova të reja dhe nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancën e sotme dëgjimore.

Kështu që në vijim po ndalem në mënyrë më të përmbledhur në propozimet e mia për secilin nga kriteret dhe treguesit përkatës të vlerësimit.

Dua të theksoj që një element i rëndësishëm i procedurës së vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në rastin konkret janë burimet e vlerësimit, të cilat në mënyrë analitike evidentohen në projektraport duke filluar me të dhënat e dosjes personale të gjyqtarës të cilat janë mbikëqyrur gjatë përgatitjes së projektraportit dhe janë vlerësuar si një burim vlerësimi në projektraport; është raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës së komanduar për gjithë periudhën, i cili pasqyron një përmbledhje faktike të detyrave dhe të aktiviteteve të tjera të kryera prej saj për periudhën e komandimit, gjatë të cilës dua të theksoj që ka ushtruar detyrën e nëpunëses përgjegjëse pranë Njesisë Mbështetëse të Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve të krijuar me vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 të KLGJ-së.

Burim i rëndësishëm i vlerësimit është mendimi i strukturës përgjegjëse organizative. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, e cila në mënyrë analitike për çdo tregues pasqyrohen në projektraport vlerësimin që kanë bërë për gjyqtaren.

Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore që janë dhënë ndaj gjyqtarës.

Të dhënat për pjesëmarrjen e saj në programet trajnuese të shkollës dhe në institucione të tjera.

Raporti i kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të përgatitura nga ILDKPKI.

Burim i rëndësishëm është edhe vetëvlerësimi që gjyqtarja e komanduar ka bërë lidhur me veprimtarinë e saj profesionale për periudhën e vlerësimit.

Lidhur me kriterin e parë që është “Aftësia profesionale”, aspekti i njohurive ligjore, treguesi “Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, për këtë tregues, burimet e vlerësimit janë: Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës; Mendim i strukturës përgjegjëse organizative; Vetëvlerësimi i gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të analizës të të gjitha të dhënave të burimeve të vlerësimit të pasqyruara në projektraport, rezulton se në tërësi, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional, të ngritur pranë Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, të saktë dhe të plotë të të dhënave, identifikimin shumë të qartë natyrës së çështjes, gjetjeve konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit. Rezulton aftësia e saj për përmbledhjen dhe evidentimin e elementëve thelbësorë që lidhen me analizën e gjetjeve, duke përcaktuar qartë dhe në mënyrë të shprehur gjetjet konkrete, të cilat analizohen si veçmas, ashtu dhe në tërësi, në funksion të kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja identifikohen dispozita të ligjit dhe akteve nënligjore, të cilat mbështesin argumentimin ligjor të saj lidhur me gjetjet në projektraportet e subjekteve të rivlerësimit. Përbën vlerë të shtuar, identifikimi dhe referimi në mbështetje të arsytimit ligjor, i praktikës së GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, kam vlerësuar se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” duhet të vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësia për të interpretuar ligjin”, referuar të njëjtëve burime të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja gjatë ushtrimit të detyrës si nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretim të ligjit të zbatueshëm, në mbështetje të analizës së gjetjeve në kuadër të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, aftësi e cila në mënyrë të dukshme evidentohet edhe në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative. Po ashtu, rezulton kujdesi i saj për të zbatuar por edhe marrë në analizë parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe për të pasuruar interpretimin e saj mbi ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij, me qëndrime të praktikës gjyqësore atje ku ajo ka qenë e nevojshme. Për këtë arsye, pikëzimi është me 25 pikë. Shkallë shumë e lartë aftësie.

Për sa i përket “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria”, nga tërësia e burimeve të vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për qartësinë dhe koncizitetin e evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, kuptueshmërisë së analizës së të dhënave të grumbulluara, arsyetimit ligjor dhe paraqitjes së përfundimeve të nxjerra sipas kritereve matëse të vlerësimit, duke ndjekur me saktësi formën standarde të miratuar nga Komisioni. Për këtë shkak, shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi 15 pikë.

Për sa i përket “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar”, nga të gjitha burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, të projektraporteve sipas formës standarde, duke i kushtuar rëndësi evidentimit të gjetjeve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të gjetjeve dhe analizës sipas kritereve të vlerësimit të subjekteve. Për këtë arsye kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie. Pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të parë që është “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, bazuar në të njëjtat burime vlerësime, por kryesisht në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative, i cili ka një rol të rëndësishëm vlerësues,

evidentohet aftësia e gjyqtares në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar, duke treguar dukshëm aftësi për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit përkundrejt analizës së kriterëve të vlerësimit të subjekteve. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtares së komanduar, aftësia e saj për këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë” sikundër edhe struktura ka propozuar. Në pikëzimin e këtij treguesi, konsiderohen edhe të dhënat lidhur me mungesën e rasteve kur dokumentet ligjore të hartuara prej saj të jenë kthyer nga struktura përgjegjëse organizative për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në dokumentet ligjore burim vlerësimi. Shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi 25 pikë.

Përfundimisht për kriterin e parë, niveli i vlerësimit që propozohet është “Shkëlqyeshëm”. Pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive organizative”.

Tek “Aftësitë organizative”, si burime vlerësimi për të gjithë treguesit, veç raportit vjetor përshkruar të punës së gjyqtares së komanduar; mendimit të strukturës përgjegjëse organizative është edhe mendimi i strukturës përgjegjëse administrative për vlerësimin e veprimtarive të tjera, në të cilat është ngarkuar gjyqtarja e komanduar; si dhe vetëvlerësimi i saj në formularin përkatës.

Lidhur me të dhënat (për aspektin e parë), rezulton se gjyqtarja e komanduar, për sa i përket “Aftësisë për të realizuar volumin normal të punës”, gjatë periudhës së vlerësimit ka hartuar 14 projektraporte standarde të analizimit të aftësive profesionale për 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë nga të cilët 10 (dhjetë) projektraporte u përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apelit dhe 3 (tre) projektraporte u përkasin gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë. Ndërkohë ka hartuar edhe 1 (një) projektraport shtesë i cili ka pasur për objekt pune vlerësimin e denoncimeve të shtetasve ndaj një gjyqtari tjetër.

Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, në zbatim edhe të Rregullores së miratuar nga KLGJ, ka marrë pjesë në të gjitha shortet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në bashkëpunim me komisionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e 5 (pesë) dosjeve me short në funksion të hartimit të projektraportëve për subjektet e rivlerësimit.

Në periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020, përtej detyrave të kryera si nëpunëse përgjegjëse/inspektore në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, me urdhër të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtarja është ngarkuar me detyra të tjera me natyrë: pjesëmarrje në 3 (tre) grupe pune, përfaqësime në 2 (dy) procese gjyqësore, si dhe grumbullim informacioni mbi problematika të pretenduara nga subjekte të ndryshme ndaj veprimtarisë së disa kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve si dhe kancelarëve, apo zbatim vendimesh të KLGJ-së, në 6 (gjashtë) raste.

Më analitik e keni të përcaktuar volumin e punës së përballuar nga ana e gjyqtares, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative si dhe strukturës përgjegjëse administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, duke qenë se gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, si për përballimin e volumit të punës së caktuar nga komisioni pranë të cilit ka punuar ashtu edhe për shkak të angazhimit në detyra të tjera, aftësia e saj për këtë tregues duhet të vlerësohet maksimalisht dhe të pikëzohet me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësia për të respektuar afatet”, bazuar në të njëjtat burime vlerësimi, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative, evidentohet se: Magjistratja e komanduar {...}, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur detyrat që i janë caktuar. Në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale, magjistratja ka respektuar në çdo rast afatet e vendosura nga strukturat eprore, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera, jo vetëm në afat por edhe në cilësi. Nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të saj.

Edhe mendimi i strukturës përgjegjëse administrative është i njëjtë. Ajo ka konkluduar se: Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtares së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit dhe situatës faktike të lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, gjyqtarja e komanduar ka realizuar në kohë reale dhe afate të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore detyrat e ngarkuara për trajtim, mbështetur në të dhëna të konstatuara.

Bazuar në burimet e vlerësimit por edhe vetëvlerësimin e gjyqtares, duke qenë se nga strukturat përgjegjëse gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht, propozimi është që shkalla e aftësisë të vlerësohet nga Këshilli si shumë e lartë dhe pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket 2.B. Efektiviteti dhe metodologjia.

Duke marrë parasysh mendimin e strukturës përgjegjëse organizative e cila shprehet se: Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar, në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin, shfaq aftësi në qenien efektive në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprorë. Me marrjen e detyrës së caktuar, shfaq qartësi në identifikimin e shpejtë të veprimeve të nevojshme për t'u kryer, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre, duke qenë efektive në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera në funksion të arritjes së një objekti në planet e punës të realizuar nga ana e saj. Gjyqtarja shfaq aftësi në dallimin e çështjeve, trajtimi i të cilave ka përparësi dhe merr masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Magjistratja në çdo rast është kujdesur në bashkëpunimin maksimal me anëtarët e Komisionit pranë të cilit ka qenë e komanduar, me anëtarët e Këshillit, me strukturat administrative të Këshillit në funksion të përmbushjes në afat të detyrave të ngarkuara. Si pjesëmarrëse në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga urdhri përkatës i nxjerrë nga struktura eprorë.

E njëjta shkallë shumë e lartë aftësie evidentohet edhe në mendimin e strukturës përgjegjëse administrative si dhe në vetëvlerësimin e gjyqtares së komanduar. Për këtë arsye edhe propozimi për këtë tregues është për shkallë shumë të lartë aftësie. Pikëzimi me 25 pikë.

Sa i përket 2.C.a. Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit.

Nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja ka treguar kujdes që aktet e dosjes të jenë të administruara dhe të renditura në mënyrë të rregullt duke ndjekur rendin kronologjik të hartimit të dokumentit dhe në tërësi e bëjnë materialin lehtësisht të shfrytëzueshëm nga çdo përdorues. Shkalla e aftësisë shumë e lartë. Pikëzimi 10 pikë.

Për sa i përket 2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit, nga strukturat është evidentuar se gjyqtarja ka treguar gjithmonë kujdes që në aktet e dosjes të jenë

dokumentet e rregullta, të plota dhe të sakta në aspektin formal të tyre. Shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi 15 pikë.

Për këtë arsye, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative” kam propozuar nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 100.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, burimet e vlerësimit për të gjithë treguesit e këtij kriteri janë:

Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative; Vetëvlerësimi i gjyqtares; Vendimet përfundimtare për masat disiplinore; Rezultatet e verifikimit të ankesave; Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Nga vëzhgimi i të gjitha burimeve të vlerësimit nuk ka pasur të dhëna që mund të afektojnë angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, nuk ka pasur dhe as zbatuar masa disiplinore, nuk ka pasur të dhëna për ankesa të trajtuara gjatë kësaj periudhe vlerësimi për gjyqtaren {...}. Prandaj për 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 35 pikë.

Për sa i përket “Integritetit”, veç këtyre burimeve është evidentuar edhe një burim tjetër që është raporti i ILDKPKI-së, i cili ka konkluduar se: deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje; nuk ka kryer deklarim të rremë; kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Për këtë arsye është vlerësuar duke marrë parasysh edhe të dhëna të tjera të burimeve: mungesën e masave disiplinore, ankesat, të dhënat dhe mendimin e strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative. Shkallë shumë e lartë aftësie, me 40 pikë.

Për sa i përket 3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese, nga të gjitha të dhënat e burimeve nuk ka rezultuar që ajo të ketë përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, propozohet shkallë shumë të lartë të aftësie. Pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të tretë, nuk ka pasur të dhëna për heqje dorë nga ndonjë procedurë administrative. Për këtë arsye, të dyja strukturat e kanë vlerësuar të pakonsiderueshëm këtë numër të kërkesave sepse nuk ka pasur të tilla. Pikëzimi është me 15 pikë.

Përfundimisht për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Pikët 100.

Për sa i përket kriterit të katërt “Aftësia e komunikimit”, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent, nga të gjitha mendimet e strukturës përgjegjëse organizative, administrative, vetëvlerësimi, dhe burime të tjera të vlerësimit, nuk kanë rezultuar të dhëna lidhur me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të nëpunëses përgjegjëse në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët. Përkundrazi evidentohen nga strukturat aftësitë e saj për komunikimin korrekt dhe të drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e komunikimit formal gjatë ushtrimit të detyrës. Shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi me 25 pikë.

E njëjta shkallë aftësie propozohet edhe për 4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, 4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale. Shkallë shumë e lartë aftësie edhe për sa i përket 4.B.b. Gatishmërisë dhe kontributit për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese, sepse sikundër ka përshkruar edhe në raportin e punës, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka qenë e gatshme dhe ka dhënë kontribut në pjesëmarrje aktive në tre grupe pune të ngritura me urdhër të Kryetares, që kanë të bëjnë me:

Urdhrin “Për hartimin e projektraportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018”. Urdhri “Për evidentimin dhe regjistrimin e praktikave të paprotokolluara në Zyrën e Protokoll arkivës nga inspektorët”; Urdhrin “Shtesë të urdhrit, për evidentimin edhe të praktikave të një inspektorit, i cili kishte paraqitur dorëheqjen”.

Në tërësi, duke marrë parasysh se sipas Metodologjisë së Pikëzimit për këtë tregues, pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri dy pikë të tjera, iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, përtej hartimit të projektraporteve

analitike për efekt të vlerësimit etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, kam vlerësuar që duhet të pikëzohet maksimalisht, me 5 pikë.

E njëjta shkallë aftësie evidentohet edhe për sa i përket treguesit të 4.B.c. Aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë.

Për sa i përket 4.C.a. Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera, ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses në 12 aktivitete të zhvilluara gjithsej në 20 ditë kalendarike, të cilat sipas Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 20 pikë.

Për sa i përket tre treguesve të tjerë 4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve, 4.C.c. Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe 4.C.ç. Publikimet ligjore akademike, nuk ka rezultuar të dhëna, për këtë arsye propozimi është pikërisht me 3, 3, dhe 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e fundit të “Aftësive personale dhe angazhimit profesional” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 91.

Për të përmbledhur propozimet për katër kriteret e vlerësimit:

1. Aftësia profesionale, 100, “Shkëlqyeshëm”.
2. Aftësia organizative, 100, “Shkëlqyeshëm”.
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100, “Shkëlqyeshëm”.
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 91, “Shkëlqyeshëm”.

Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”. Pikët 391.

Janë hartuar në projektraport edhe rekomandimet përkatëse dhe propozimet që gjyqtarja duhet t'i ketë parasysh në angazhimin e saj të vazhdueshëm për sa i përket kryesisht veprimtarive ndërinstitucionale dhe përfshirjen e saj në trajnimin e gjyqtarëve apo edhe në fushën akademike.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me miratimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

- A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 01.06.2020”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 01.06.2020”, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 01.06.2020”, për të cilin është përgatitur relacioni me relatore zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë do ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 01.06.2020, i cili është bërë konform rregullave të reja të miratuara me vendimin nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin ka filluar me vendimin nr. 176, datë 25.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Janë administruar të gjitha burimet e vlerësimit të cilat janë pasqyruar në mënyrë kronologjike tek procedura e kryer.

Më pas, pas plotësimit të dokumentacionit është vendosur nga Komisioni plotësimi i procedurës dhe njoftimi i projektraportit të vlerësimit gjyqtarit të komanduar.

Gjyqtari është njohur me projektraportit të vlerësimit. Nuk ka paraqitur kundërshtime. Gjithashtu është njoftuar edhe për seancën e sotme dhe nuk ka kërkuar të jetë prezent.

Në pjesën e dytë të projektraportit janë pasqyruar burimet e vlerësimit, ku ndër to janë të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit; raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në KLGJ i hartuar nga gjyqtari i komanduar, dhe i nënshkruar edhe nga struktura përgjegjëse organizative, mendimi i strukturës përgjegjëse organizative protokolluar pranë KLGJ-së më datë 22.05.2023 i cili përmban mendimin dhe vlerësimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, si struktura përgjegjëse organizative për shkak të mbikëqyrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative të punës së gjyqtarit, ku gjyqtari ka ushtruar funksionin; mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, i protokolluar më datë 17.05.2023; të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura dhe vendimeve përfundimtare për masat disiplinore që janë dhënë ndaj gjyqtarit, ku nuk rezultoi që ndaj gjyqtarit të jenë dhënë masa disiplinore apo të jetë paraqitur ndonjë ankim; të dhëna për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit të komanduar në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, ku janë evidentuar të gjitha aktivitetet (konkretisht 11 aktivitete); raporti i Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, ku ka rezultuar se deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë, nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave; vetëvlerësimi i gjyqtarit së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në pjesën tjetër, pasqyrohet analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi. Konkretisht, për kriterin e parë “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, konkretisht për treguesin 1.A.a.

Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm.

Në këtë pjesë është pasqyruar raporti përshkrues vjetor i punës, mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, mendimi i dhënë lidhur me këtë tregues, si dhe konkluzionet e kësaj strukture përgjegjëse.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari i komanduar, gjatë periudhës së vlerësimit, ka përfunduar hartimin e projektraportit të analizimit të aftësisë profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjekte të rivlerësimit (nga të cilët 10 raporte iu përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apeleve dhe 9 raporte të tjera iu përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të shkallës së parë). Gjyqtari, në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, ka mbajtur në konsideratë “burimet” për rivlerësimin e aftësisë profesionale të parashikuara në nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe “burimet” e parashikuara në nenin 12 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve”. Në hartimin e projektraporteve, nëpunësi përgjegjës analizon të dhënat bazuar në (i) formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

Nga burimet e vlerësimit rezulton se, krahas kushteve dhe kritereve të përgjithshme të vlerësimit profesional dhe etik, për secilin gjyqtar në varësi të shkallës së gjykimit, në varësi të juridiksionit gjyqësor, gjyqtari i komanduar zbaton edhe kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjet specifike që rregullojnë veprimtarinë e gjykatës ku ushtron veprimtarinë gjyqtari, si për shembull parashikimet e ligjit nr. 9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Në respektim të strukturës së projektraportit, paraqet dhe rendit faktet që rezultojnë nga dokumentet që përbëjnë burim vlerësimi duke analizuar kështu aftësitë profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit të cilat përbëjnë objektin e vlerësimit,

duke u ndaluar vetëm në elementë të vlerësimit që janë të rëndësishme dhe domethënëse dhe duke shmangur elementët e panevojshëm.

Zoti Zaimi ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor, në tetë procese gjyqësore. Në këto procese gjyqësore, në cilësinë e përfaqësuesit të palës së paditur, ka identifikuar saktë pretendimet e palës paditëse dhe argumentet kundërshtuese të saj në lidhje me vendimmarrjen e Këshillit objekt shqyrtimi gjyqësor. Gjithashtu gjyqtari i komanduar ka evidentuar saktë përmbajtjen e vendimit të Këshillit objekt ankimi, ka përgatitur prapësimet dhe argumentet kundërshtuese ndaj padisë, si dhe ka përgatitur konkluzionet përfundimtare. Në këto procese gjyqësore, ka pasur të qartë natyrën e pretendimeve të palës paditëse, duke dhënë përgjigje ligjore për këto pretendime, në funksion të mbrojtjes së vendimmarrjes së Këshillit.

Zoti Zaimi edhe në rastin e urdhrave të tjerë të nxjerrë nga titullari i Këshillit, ka pasur të qartë objektin e punës që duhej të kryente, natyrën e çështjes, si dhe ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien objekt trajtimi.

Nga analiza e të dhënave rezulton se gjyqtari i komanduar, ka respektuar pavarësinë e subjekteve të rivlerësimit të garantuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, në vlerësimin e aftësisë profesionale të tyre. Gjyqtari i komanduar, në hartimin dhe përgatitjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për 19 (nëntëmbëdhjetë) subjektet e rivlerësimit, ka zbatuar me përpikëri kriteret e vlerësimit profesional dhe etik të përcaktuara nga sistemi i vlerësimit në fuqi, në periudhën kohore që përfshin procesi i rivlerësimit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të mira për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyrë tërësore burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, për të përcaktuar elementët faktikë të çështjes për trajtim, për të identifikuar natyrën e saj, çështjet që shtrohen për zgjidhje, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se shkalla e aftësisë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave është shumë e lartë dhe pikëzohet me 25 pikë.

Sa i përket 1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin, nga struktura përgjegjëse organizative është vlerësuar aftësia e tij shumë e lartë. Janë pasqyruar në mënyrë të detajuara dhe konkluzionet e kësaj strukture përgjegjëse. Gjithashtu është dhënë edhe mendimi i vetëvlerësimit të gjyqtarit i cili e ka vlerësuar aftësinë e tij shumë të lartë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për të evidentuar dhe zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjorë, dhe në arsyetimet me shkrim ose verbale. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria, nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në procesin e hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtari i komanduar, shfaq aftësi të larta për të shprehur mendimin e tij juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të shkurtra, të thjeshta, të kuptueshme, logjike, si dhe zbaton saktësisht rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës.

Ai kujdeset që gjuha e përdorur në projektraporte të jetë profesionale, me përdorimin si duhet të termave teknikë profesionale, si dhe duke përdorur të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të projektraporteve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, jo vetëm për organet e vetting-ut por për çdo lexues. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit në çdo nënndarje të projektraportit, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të tij, sipas përmbajtjes. Dokumentet ligjorë të hartuar apo përpunuar nga gjyqtari i komanduar janë të qartë, koncize dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe të lexueshëm. Dallohet qartë përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë,

zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin si dhe përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumenteve ligjorë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar i kushton vëmendjen e duhur strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve. Në të gjitha projektraportet e përgatitura prej tij, ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve. Gjithashtu rezulton se ai paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit. Përdor si duhet konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nënndarje dhe paragrafë sipas rastit.

Gjyqtari i komanduar menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në funksion të realizimit të afateve kohore, pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që duhen kryer si dhe ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës.

Në konkluzion, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të larta për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, në dokumentet ligjorë të hartuar/përpunuar prej tij, strukturë të cilës gjyqtari i komanduar i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit. Ai ndjek një metodologji të caktuar sipas pjesëve përbërëse të projektraporteve, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Gjyqtarit të komanduar nuk i është kthyer asnjë dokument ligjorë nga strukturës përgjegjëse organizative për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e dakordësuar më parë, sipas rastit.

Pas analizës së të dhënave, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit të komanduar në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në përmbajtjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe etike, konstatohet qartë se gjyqtari i komanduar, i kushton vëmendjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Në argumentimin e tij ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë pasur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, gjyqtari i komanduar zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi.

Në asnjë rast, Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve, nuk i ka kthyer për ripunim projektraportet e hartuara prej tij, për mangësi në argumentimin ligjor apo për arsye të mungesës logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre vlerësohet se cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjorë të hartuar apo përpunuar nga gjyqtari është e lartë. Gjyqtarit i komanduar ka aftësinë për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim. Në asnjë rast nuk i janë kthyer projektraportet nga struktura përgjegjëse për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit të komanduar për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për kriterin e vlerësimit “Aftësia profesionale” është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësia organizative”, edhe këtu burimet e vlerësimit janë të njëjta.

Referuar burimeve të vlerësimit rezultoi që gjyqtari ka përballuar një volum të lartë pun. Në cilësinë e nëpunësit përgjegjës pranë Njësisë Mbështetëse të Komisionit

të Përkohshëm, ka përfunduar dhe dorëzuar pranë Komisionit, gjatë periudhës së vlerësimit 19 (nëntëmbëdhjetë) projektraporte të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë të shkallëve të para si dhe për gjyqtarë apeli. Referuar mendimit të strukturës përgjegjëse organizative rezulton se përgatitja e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale është një proces që kërkon realizimin e shumë veprimeve deri në finalizimin e tij. Gjyqtari i komanduar ka shfaqur gjithnjë një përkushtim maksimal gjatë procesit të hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe jo vetëm.

Përgatitja e projektraportve është kryer në respektim të parashikimeve të: Ligjit nr. 84/2016, nr. 96/2016 si dhe përcaktimet e Rregullores: “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm” si dhe në mbështetje të aktit të miratuar nga KLGJ-ja.

Gjyqtari i komanduar, në raportin përshkrues të punës, referon se, në hartimin e projektraporteve profesionale të subjekteve të rivlerësimit, para hyrjes në fuqi të Rregullores së miratuar nga KLGJ-ja me vendimin nr. 24, datë 07.02.2019, ka ndjekur dhe zbatuar formatin standard, kushtet dhe kriteret e parashikuara në vendimin nr. 49, datë 16.10.2017, të miratuar nga Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Nga burimet e vlerësimit, rezulton se, në hartimin e projektraporteve, gjyqtari ka përgatitur me përparësi dhe në përputhje me udhëzimin e Komisionit të Përkohshëm, raportet që i përkasin subjekteve e të cilëve janë kërkuar me urgjencë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në hartimin e projektraporteve, gjyqtari ka treguar një përkushtim të lartë, me qëllim që projektraportet të përfundohen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, por kurrësi pa cenuar cilësinë e përmbajtjes.

Bazuar në Raportin përshkrues statistikor të hartuar nga gjyqtari i komanduar, rezultoi se ai përveç hartimit të projektraportve profesionale, ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar atij nga struktura eprorë administrative.

Kështu, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, rezultoi se z. Zaimi, ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 8 (tetë) procese gjyqësore ku Këshilli ka qenë palë e paditur.

Në ato procese gjyqësore, ka përgatitur prapësimet, por edhe konkluzionet me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara gjykatës.

Rezultoi gjithashtu, se gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, ka marrë pjesë në dy grupe pune të ngritura me urdhër të posaçëm nga Kryetarja e KLGJ-së.

Bazuar në përmbajtjen e raportit përshkruar statistikor, rezulton z. Zaimi, është ngarkuar nga titullari i KLGJ-së, edhe me kryerje të detyrave të tjera, të cilat përshkruhen hollësisht prej tij në raportin përshkruar të punës të hartuar nga vetë gjyqtari i komanduar.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera të përshkruara më sipër si pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit të komanduar për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të respektuar afatet parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo atyre të caktuara apo sipas rastit e natyrës së punës. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari i komanduar ka aftësi shumë të mira për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit 2.B.a. Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës, edhe në këtë tregues janë përshkruar vetëvlerësimi i gjyqtarit, mendimi i strukturës përgjegjëse administrative dhe i strukturës përgjegjëse administrative.

Referuar këtyre burimeve, rezulton se z. Zaimi ka një eksperiencë të gjatë si gjyqtar i komanduar, fakt që i jep mundësinë që të jetë mjaft efektiv në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprorë. Rezulton se gjyqtari i ka mjaft të qarta

veprimet që duhet të ndërmarrë kur njihet me detyrën që i është ngarkuar të kryejë, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre.

Gjyqtari i komanduar është në gjendje të dallojë çështjet, trajtimi i të cilave ka përparësi/urgjencë dhe të marrë masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme.

Gjithashtu, kur ka marrë pjesë në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga urdhrat përkatës të nxjerrë nga struktura eprorë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burimet e tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës, duke evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi si dhe ato me probleme procedurale.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtari i komanduar, si në rastin e hartimit të projektraporteve profesionale, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës përgjegjëse.

Për sa më sipër rezulton se gjyqtari i komanduar ka treguar aftësi shumë të larta në renditjen e akteve dhe rregullshmërinë e dokumentacionit (fizik apo elektronik) të administruar, dokumentacion që gjyqtari i komanduar i përcjell strukturës përgjegjëse ku ai shërben sipas rastit ose strukturave të tjera të Këshillit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar ka administruar, mbajtur dhe mbikëqyrur me mjaft kujdes dokumentacionin, aktet shkresore që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projektraportit të analizimit të aftësive profesionale. Aktet e dosjes kanë qenë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për kriterin e vlerësimit “Aftësia organizative” është 100 pikë. Niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Referuar sa më sipër, rezulton se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtarit”, 3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Si burime vlerësimi për këtë tregues janë: Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative; Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative; Vetëvlerësimi i gjyqtarit; Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, ku rezultoi se ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore, as nuk ka ankesa, rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD; Të dhënat e raporteve të ILDKPKI-së.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer gjyqtarit të komanduar, ai ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e gjyqtarit dhe nuk konstatohet në asnjë rast, të ketë shfaqur anësi në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, apo të ketë favorizuar ose paragjykuar ndonjë prej tyre.

Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Për sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit si dhe parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari i komanduar duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi rezulton se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarit të komanduar”, 3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari i komanduar në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e projektraporteve apo dokumenteve të tjerë të hartuar prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari i komanduar ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij është shumë e lartë për këtë tregues dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara për përjashtim...

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuara për përjashtim si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është kërkuar asnjëherë përjashtimi i tij, si dhe nuk ka hequr dorë nga asnjë procedurë administrative.

Sa më sipër, aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kriteri i katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht “Aftësia e komunikimit”, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”.

Nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit apo vlerësimit, për të cilat ka ardhur në dijeni.

Referuar sa më sipër, për këtë tregues, vlerësohet se aftësia e tij është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për sa më sipër vlerësohet se aftësia e tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë një deri 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarit së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, vlerësohet se aftësia e tij në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë. Konkretisht ai ka marrë pjesë edhe në grupe

pune të cilat janë caktuar nga organi epror si dhe ka përfaqësuar Këshillin në disa procese gjyqësore.

4.B.c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje.

Nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje, është shumë e lartë. Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, 4.C.a. Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues...

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i komanduar ka marrë pjesë në 11 aktivitete trajnuese, të zhvilluara për 19 ditë kalendarike. Referuar sa më sipër, duke qenë se ka marrë pjesë në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare (në fakt ai vlerësohet për një periudhë 1 vit e gjysmë), duke qenë kështu brenda kufijve të përcaktuar për këtë periudhë.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve.

Nuk rezultojnë të dhëna për këtë tregues. Për sa më sipër është pikëzuar me 3 pikë.

4.C.c. Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale...

Edhe për këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarit të komanduar në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Për këtë arsye edhe për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

Edhe për sa i përket treguesit 4.C.ç. Publikimet ligjore akademike, nuk rezultoi asnjë e dhënë që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë bërë publikime ligjore akademike.

Referuar sa më sipër propozimi për nivelin e vlerësimit për këtë tregues është 91 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit është si më poshtë:

1. Aftësia profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".
2. Aftësia organizative, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm, 391 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në fund të projektraportit janë bërë edhe propozimet dhe rekomandimet që gjyqtari të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të tij për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

Bashkëngjitur projektraportit është edhe shtojca përkatëse e vlerësimit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk kanë diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020", *(lapsus në projektvendim në titull periudha e vlerësimit e cila duhet 01.01.2019 - 01.06.2020).*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor z. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:

- A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatore *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (z. {...}), për shkak të dorëheqjes së saj.

Zonja {...} ka ushtruar detyrën e kancelares pranë ish-Gjykatës së Apelit Durrës dhe pas ristrukturimit të gjykatave të apeleve, në zbatim të hartës së re gjyqësore, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 63, datë 01.02.2023 është transferuar dhe ushtron detyrën e kancelares pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Më datë 14.07.2023, znj. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i punës si kancelare pranë gjykatës ku ajo ushtron detyrën, pra pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 80, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim, zonja {...} ka depozituar edhe një kërkesë tjetër, më saktë një motivim të kërkesës për dorëheqje të paraqitur, duke kërkuar në referim të nenit 80, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016, trajtimin e kërkesës së saj në mënyrë të përsheptuar, pra ka kërkuar përsheptimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës me arsyetimin: ...angazhime profesionale të saj, pasi ka fituar provimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe është në procedurë verifikimi nga KLGJ-ja, si dhe ka vendosur si shkak tjetër motivues për përsheptimin e procedurës së saj, faktin që ka një fëmijë të mitur aktualisht me probleme shëndetësore, që kërkon përkujdesjen e saj të vazhdueshme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika c të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka në kompetencë të tij ndër të tjera emërimin e kancelarëve të gjykatave. Në nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, përcaktohet se: “*Organi kompetent për emërimin e kancelares, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor ...*”.

Ndërkohë, lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës dhe përfundimin e saj, në nenin 80 të Ligjit nr. 98/2016, parashikohet se: “...3.Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësor është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën”. Në këtë dispozitë theksohet se ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Në nenin 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Nëpunësi mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim të njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku ushtron detyrën ose DAP-it, në rastin e nëpunësit të TND-së. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi...”.

Sa më sipër, në kushtet kur për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga kancelari në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë znj. {...}, vlerësohet se është vërtetuar një ndër shkaqet ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës dhe sipas parashikimeve të nenit 64 të Ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar, marrëdhënia e punës duhet të deklarohet e përfunduar për shkak të dorëheqjes së paraqitur.

Bazuar edhe në motivacionin e paraqitur nga zonja {...}, propozohet që dorëheqja e paraqitur, t’i prodhojë efektet përpara afatit 30-ditor, nga data e paraqitjes së saj.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit është përcaktuar disponimi për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për znj. {...}, për shkak të vërtetimit të një prej shkaqeve ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës.

Në pikën 2 të projektvendimit është përcaktuar njoftimi i vendimit znj. {...}, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në fund të projektvendimit përcaktohet se vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Një pyetje për relatoren.

Ju e keni trajtuar si heqje dorë dhe nga statusi i nëpunësit gjyqësor civil? Sepse zonja { ... } ka hequr dorë si kancelare në detyrë.

Marçela Shehu: Po!

Brikena Ukperaj: Pra kjo heqje dorë nënkupton edhe heqjen dorë nga statusi i nëpunësit, sepse kancelari mund të heqë dorë nga pozicioni, por mund të shkojë në një pozicion tjetër.

Marçela Shehu: Është trajtuar njësoj si të gjitha rastet e tjera (si te rasti i zotit { ... }).

Brikena Ukperaj: Domethënë shprehja e vullnetit për të hequr dorë nga kancelari në detyrë është shprehje e vullnetit për ta përfunduar tërësisht marrëdhënien e saj në shërbimin gjyqësor civil.

Atëherë, unë mendoj, duke qenë se nga relatorja vjen propozimi që efektet e vendimit duhet të fillojnë para afatit 30-ditor, në projektvendim duhet të jetë e përcaktuar data se kur do t'i fillojnë efektet vendimit. Është njësoj si dorëheqjet e gjyqtarëve kur ne i bëjmë të motivuara përpara mbarimit të muajit pasardhës nga paraqitja e dorëheqjes. Edhe këtu në këtë rast për nëpunësit civilë, duke qenë se zbatohen dispozitat edhe për analogji për nëpunësit gjyqësorë civilë, efektet e dorëheqjes normalisht përfundojnë brenda 30 ditëve (është e parashikuar në relacion). Duke qenë se është trajtuar dorëheqje e motivuar, efektet e vendimit duhet të prodhojnë paraprakisht, por ne duhet të caktojmë datën se kur, se kancelarja mund të ketë (të themi) edhe dy ditë punë ose tre ditë punë. Kjo është ideja. A duhet të kemi një datë të përcaktuar në vendim?

Marçela Shehu: Të kuptoj.

Unë kam ndjekur në fakt të njëjtin standard dhe të njëjtin moment të hyrjes në fuqi si në rastin e kancelarëve të tjerë për të cilët kemi disponuar njësoj. Prandaj e referova rastin e zotit { ... }. Për zotin { ... } kemi ndjekur të njëjtin standard, që ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë dhe i ka sjellë efektet në mënyrë të menjëhershme. Nëse

Këshilli vlerëson se duhet një moment tjetër, pra të jetë dita e nesërme, unë nuk kam ndonjë kundërshtim. Por ama ju sjell në vëmendje që do të ndryshojmë atë standardin e atij vendimi që kemi ndjekur tek rasti i zotit {...}.

Brikena Ukperaj: Atëherë, me sa kuptova, relatorja e ka sjellë me propozimin që meqenëse vendimi hyn sot, dorëheqja i prodhon efektet sot. Efektet e vendimit fillojnë sot. Domethënë vendimi hyn në fuqi menjëherë sot, do të thotë që edhe efektet do t'i prodhojë sot ky vendim.

Marçela Shehu: Po!

Brikena Ukperaj: Në vlerësimin tim duhet të lihet një afat, ndoshta deri në fund të korrikut, në qoftë se do të ishte e mundur, për arsye, sepse kancelari është një nëpunës civil shumë i rëndësishëm dhe në përbërje të këshillit të gjykatës dhe që mbikëqyr procedurat e shortit. Në qoftë se ne do të marrim vendim sot, ndoshta duhet të ketë edhe një zgjidhje se çfarë do të bëhet me kancelarin e gjykatës për vijimin.

Marçela Shehu: Atëherë, Brikena!

Në rastin kur u trajtua rasti i kancelarit të Dibrës, vendimit iu dha efekti menjëherë. Bile është diskutuar në Këshill dhe nuk u mendua fare se çfarë do bëheshe me pozicionin e kancelarit. Sigurisht që ne duhet të mendojmë, por ama kjo i përket një të ardhmeje besoj.

Brikena Ukperaj: Kujt i përket? Ne jemi organ emërtese. Kujt i përket?

Marçela Shehu: Ta emërojmë sot kancelarin e ri?

Brikena Ukperaj: Jo pra, nuk e emërojmë sot. Ndoshta duhet menduar. Ju si Komision...

Marçela Shehu: Sigurisht që do e mendojmë. Por sot ne nuk kemi një propozim për kancelarin e ri.

Po të sjell në vëmendje për analogji rastin e Gjykatës së Dibrës. Në momentin që kancelari dha dorëheqjen dhe kërkoi dorëheqjen me efekt të përshpejtuar, sepse do fillonte një punë tjetër, Këshilli e pranoi dorëheqjen, i ndërpreu marrëdhëniet në shërbimin civil gjyqësor, i dha efekt të menjëhershëm.

Sigurisht që është i drejtë shqetësimi që Këshilli do duhet të mendojë për vijimin dhe për caktimin në detyrë të një kancelari tjetër. Unë sigurisht do ta referoj në Komision dhe pastaj i takon mbledhjes plenare të vendosë.

Ilir Rusi: Atëherë zonja Ukperaj, për sa parashtron, keni ndonjë propozim konkret?

Brikena Ukperaj: Mendoj që duhet të jetë e përcaktuar, siç themi edhe për të gjitha rastet e transferimeve, në të gjitha rastet, faktin që nuk e parashikua tek z. {...} nuk do të thotë se është një standard që duhet ta ndjekim. Mendoj që duhet të jetë patjetër efektet juridike të vendimit me një datë të përcaktuar (sot, nesër, në 31 korrik). Thjesht mendoj që duhet të jenë të përcaktuara efektet juridike. Në qoftë se nga Komisioni propozohet të jetë data e sotshme, atëherë bëjmë datën e sotshme, 25.07.2023. Unë mendoj që efektet duhet të jenë të përcaktuara.

Marçela Shehu: Doni të shtojmë një pikë?

Atëherë një pikë e tretë: Efektet fillojnë më datë 25.

Ilir Rusi: Atëherë, për sa u diskutua nga ana e relatores ka një shtesë në projektvendim.

Marçela Shehu: Po, kemi një shtesë në pikën 3 të projektvendimit, bazuar edhe në sugjerimin që dha kolegja, lidhur me momentin e krijimit të efekteve, që mos të ketë konfondim me hyrjen në fuqi, të jetë data e përcaktuar. Ne propozojmë që efektet, ky vendim, t'i krijojë sot.

Ilir Rusi: Pra zonja Shehu, pas pikës 1 të shtohet pika 2 në lidhje me efektet e këtij vendimi, që do jetë data 25 dhe pastaj pika 2 është pika 3 që një kopje e vendimit i njoftohet zonjës... Ky është propozimi?

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi duke marrë në konsideratë edhe ndryshimin e bërë nga relatorja në lidhje me fillimin e efekteve juridike të këtij vendimi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, kancelare në detyrë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të dorëheqjes.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 25.07.2023.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

52

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 25.07.2023 (Pika 5)***

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastër dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastër dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në kohë të ndryshme janë administruar kërkesa për caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta nga gjykatat administrative të shkallëve të para dhe gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm. Këto kërkesa trajtohen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili harton relacionin dhe i paraqet propozimet Këshillit.

Në rastin konkret një numër i caktuar kërkesash (siç përmenden në vijim të këtij relacioni) të ardhura prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë të administruara pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, por kanë mbetur të pa trajtuara.

Në vendimin nr. 271, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, është parashikuar se: “1. Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mban të njëjtin emërtim pas datës 01.07.2023. 2. [...]. 3. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër ndërpresin veprimtarinë më datë 30.06.2023.

Në këto rrethana janë paraqitur disa kërkesa përpara datës 01.07.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë, që tashmë kanë mbetur pa objekt pasi kërkesat për çështjet gjyqësore të transferuara gjejnë zgjidhje sipas vendimeve të dhëna nga Këshilli me nr. 271 dhe nr. 272, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për fillimin e funksionimit të gjykatave të shkallëve të para administrative Tiranë dhe Lushnje.

Nga ana tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka paraqitur ka paraqitur paraprakisht kërkesë për plotësimin e trupit gjykues por më pas ka hequr dorë nga kërkesa për caktimin e gjyqtarit.

Prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjeve pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3, 94/1 dhe 95 të Kodit të

Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016.

Propozimi: Nisur nga rrethanat e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

i. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 2707, 2709, 2712, 2715, 2716, 2717, 2718, 4285, 7372 të Vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;

ii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: Nr. 69 të Vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;

iii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave: Nr. 711, 756, 793 të Vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë;

iv. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: Nr. 702 të Vitit 2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë;

v. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës: Nr. 233/339 të Vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Lezhë.

Faleminderit!

Këto janë propozimet.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të gjykatave administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 2707, 2709, 2712, 2715, 2716, 2717, 2718, 4285, 7372 të vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 69 të vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 711, 756, 793 të vitit 2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës:

Nr. 702 të vitit 2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës:

Nr. 233/339 të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Lezhë.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarëve të gjykatave të sipërcituara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës 6 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Në kuadrin e përpjekjeve për të plotësuar vakancat në sistemin gjyqësor, në mënyrë të veçantë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, KLGJ ka iniciuar procedurat e lëvizjes paralele. Ndër to, me vendimin

nr. 249, datë 24.05.2023 është hapur edhe procedura e lëvizjes paralele për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Një nga kandidatët i cili ka kandiduar për këtë pozicion është edhe zoti {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i cili bën pjesë tek lista e miratuar nga Këshilli me vendimin nr.346, datë 27.06.2023, tek lista e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele.

Ndërkohë më herët me vendimin nr.385, datë 17.07.2023, ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë, të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023, duke e filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në këto procedura.

Në kuadër të administrimit të dokumentacionit të nevojshëm i cili do të provonte plotësimin e kriterëve të kandidimit, u verifikua kriteri i përvojës profesionale specifike, duke marrë në konsideratë që magjistrati i cili kandidon në 5 vitet e fundit, duhet të kishte të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë në fushën civile.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2011, dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2013. Në vijim ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 130, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 153, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Aktualisht për z. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, rezulton se për periudhën nga 31 korrik 2019 deri më datë 30.04.2023 (kur ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër) dhe nga data 01.05.2023 e

në vijim, që ushtron detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ai ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, penale, civile, familjare dhe tregtare, në kushtet kur gjykata, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta, penale dhe civile.

Nga të dhënat e administruara rezultojnë të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Natyrisht u verifikuan edhe kriteret e tjera të cilat në rast verifikimi do të ndalonin konkurrimin e mëtejshëm, siç është mospasja e masës disiplinore në fuqi, e cila siç e citova edhe më lart nuk rezultojnë të jetë verifikuar. Gjithashtu edhe në rastin hipotetik të emërimit nëpërmjet lëvizjes paralele nuk verifikohen kushtet e papajtueshmërisë ambientale për të.

Kështu që në përfundim nga ana e relatorit u redaktua projekti në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Irena Plaku** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 5. Ridvan Hado** (anëtar)
- 6. Alban Toro** (anëtar)
- 7. Marçela Shehu** (anëtare)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 9. Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Gabimisht z. Toro parashtron relacionin shpjegues të projektvendimit me nr. 10 në rendin e ditës, “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Pas konstatimit të këtij fakti, zoti Toro duke kërkuar ndjesë, vijon parashtrimin e relacionit “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}”.

Alban Toro: Edhe për këtë rast, nga ana e Këshillit më herët kishin filluar procedurat e lëvizjes paralele dhe në lidhje me to, një nga kandidatet ka qenë edhe zonja {...} e cila brenda afatit të kandidimit ka paraqitur aktet për pozicionin e lirë nr. 251 datë 24.05.2023.

Me vendimin nr.385, datë 17.07.2023, ka filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele duke përfshirë edhe zonjën {...} dhe me cilësinë e relatorit u administruan aktet që do të provonin plotësimin e kritereve formale në lidhje me mundësinë e kandidimit të mëtejshëm.

Kështu që nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 19.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 7, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendim nr. 46, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendim nr. 363, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë deri në 1 vit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Me vendim nr. 400, datë 23.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për një periudhë deri në datën 01.05.2023 dhe në vijim ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nga verifikimet e

kryera, rezulton se: “Gjyqtarja {...} sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës Shkodër datë 04.02.2020 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil.; sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës Shkodër datë 24.03.2021 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil.”

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “{...} ka gjykuar çështje penale, civile, familjare dhe urdhra ekzekutimi pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duke qenë se gjyqtarët nuk kanë qenë të ndarë në dhoma specifike nga data 21.09.2021 deri më 30.04.2023.

Për kriterin e përvojës profesionale specifike minimale rezulton që gjyqtarja e gëzon.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi, të cilat do të pengonin kandidimin e mëtejshëm. Gjithashtu nuk është verifikuar as kriteri i papajtueshmërisë ambientale në rastin hipotetik të transferimit të saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nëpërmjet lëvizjes paralele.

Pra përfundimisht nga ana e relatorit është redaktuar projekti, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Edhe në rastin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga ana e Këshillit më parë kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele. Ndër to, për pozicionin nr. 253, datë 24.05.2023 ka kandiduar zonja {...},

aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Me Vendimin nr.385, datë 17.07.2023, filluan procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit dhe në këtë kuadër, nga ana e relatorit u administruan të gjithë aktet të cilat do të provonin kriteret formale të plotësuara nga ana e saj.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 08.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendim nr. 482, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 512, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite. Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike, rezulton se znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën nga 20.10.2020, (për periudhën 12.11.2020-12.04.2021 ka qenë me leje) deri me datën 30.04.2023, ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe nga data 01.05.2023 e në vijim ushtron detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Gjithashtu znj. {...} ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht çështje penale, civile, familjare dhe tregtare, pasi gjykata për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta penale dhe civile. Pra përfundimisht rezulton që të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e të drejtës penale.

Gjithashtu për të nuk u verifikuan kriteret të cilat do të ndalonin konkurrimin e saj, siç është mospasja e masës disiplinore në fuqi, që i referohet pikës 6, të nenit 43, apo nuk ekziston papajtueshmëria ambientale në rastin hipotetik të transferimit të saj në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Përfundimisht nga ana e relatorit ju propozohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2023–2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2023-2024”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Brikena Ukperaj*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2023-2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka për detyrë të përcaktojë gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, duhet të kryejnë praktikën profesionale.

Lista e gjyqtarëve udhëheqës është miratuar për një periudhë trevjeçare me vendimin 316/2021 të Këshillit, vendim i cili është përditësuar me trupën e gjyqtarëve udhëheqës në vitin 2022 dhe së fundi me vendimin nr.356/2023 të Këshillit.

Në datën 18.07.2023, nga ana e shkollës janë përcjellë listat e kandidatëve për gjyqtarë të cilët kanë përfunduar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës dhe do të kryejnë praktikën profesionale për periudhën 2023-2024 pranë gjykatave të shkallës së parë.

Nga ana tjetër, në zbatim të nenit 33 të ligjit Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për detyrë që të përcaktojë edhe gjykatat e shkallës së parë në të cilat kandidatët për magistratë do të kryejnë praktikën profesionale dhe duke ndarë edhe gjyqtarët udhëheqës përkatës, të cilët nga ana tjetër duhet të kryejnë vlerësimin etik dhe profesional për secilin kandidat duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara me ligj.

Në lidhje me përcaktimin e gjykatave, në nenin 33, pika 2 të ligjit “Për statusin”, parashikohet se: “Këshillat përcaktojnë gjykatat dhe prokuroritë e shkallës së parë, për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, bazuar në këto tregues:

- a) disponueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve udhëheqës;
- b) infrastrukturën e gjykatës dhe të prokurorisë;
- c) disponueshmërinë e hapësirës dhe mjediseve të punës për kandidatët magistratë;
- ç) mundësinë për t’u njohur me një numër të madh ligjesh dhe shumëllojshmëri çështjesh gjatë praktikës profesionale”.

Referuar kriterëve ligjore si më sipër, Komisioni ka vlerësuar që të jenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024. Një përcaktim i tillë bëhet duke konsideruar:

- (i) Ecurinë e praktikës profesionale të kandidatëve për gjyqtarë të zhvilluar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitet 2017-2022;

(ii) Numrin e kandidatëve për gjyqtarë që do të zhvillojnë praktikën profesionale në vitin akademik 2023-2024. Referuar kërkesës dhe praktikës së përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se në këtë periudhë do të ndjekin praktikën profesionale 32 (tridhjetë e dy) kandidatë për gjyqtarë të cilët në i kemi ndarë në 11, 11 dhe 10 kandidatë për secilën periudhë katërmujore;

(iii) Numrin e gjyqtarëve që kanë shprehur gatishmërinë për t'u përfshirë në listën e magjistratëve udhëheqës për secilën nga gjykatat si më sipër;

(iv) Përfshirjen e gjyqtarëve që kanë ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe gjyqtarët me përvojë profesionale të gjatë;

(v) Madhësinë dhe infrastrukturën e gjykatave respektive me qëllim krijimin e kushteve sa të optimale për veprimtarinë gjatë praktikës profesionale për kandidatët për gjyqtarë;

(vi) Klasifikimin e gjykatave respektive si gjykata të cilat kanë në kompetencën lëndore dhe tokësore të tyre një gamë të gjerë mosmarrëveshjes në fushat kryesore të të drejtës civile, penale dhe administrative;

(vii) Kërkesat e paraqitura nga kandidatët për gjyqtarë për të zhvilluar praktikën profesionale në gjykata të ndryshme, referuar rrethanave që ata kanë bërë prezent, vlerësuar në raport me mundësitë objektive për të zhvilluar praktikën në gjykatat respektive dhe numrin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, që kanë shprehur vullnetin për t'u bërë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës.

Konkretisht pranë Këshillit janë paraqitur nga kandidatët për gjyqtarë, kërkesat si më poshtë:

- Kandidatja për gjyqtare {...}, në datën 22.06.2023, ka shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për arsye familjare (bashkëngjitur ka paraqitur certifikatën e përbërjes së saj familjare);

- Kandidatja për gjyqtare {...}, në datën 23.06.2023, ka shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin që lidhet me arsyet familjare dhe shëndetësore të fëmijës të saj të mitur;

- Kandidati për gjyqtar {...}, në datë 22.06.2023, ka shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për arsye familjare (duke bashkëlidhur certifikatën e përbërjes së tij familjare).

Lidhur me këto kërkesa, Komisioni vlerëson se ato mund të konsiderohen pjesërisht në përcaktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës pranë të cilëve kandidatët do të kryejnë praktikën profesionale duke vlerësuar:

(i) Vullnetin e shprehur nga kandidatët për gjyqtarë;

(ii) Numrin e gjyqtarëve të cilët janë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës përditësuar me vendimin nr. 356/2023;

(iii) Madhësinë dhe infrastrukturën e gjykatave të kërkuara nga kandidatët, me qëllim krijimin e kushteve sa më optimale për zhvillimin e praktikës profesionale dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë kandidatët për të kryer praktikën profesionale në mënyrë sa më cilësore, në drejtim të natyrës dhe sasisë së çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat përkatëse, referuar juridiksionit dhe madhësisë së tyre.

Duke vlerësuar kushtet e mësipërme, Komisioni ka çmuar se kërkesa e kandidates {...} për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (seksion civil dhe penal), duhet të pranohet, pasi nevojat aktuale shëndetësore të fëmijës së saj janë të tilla, duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës që për shkak të sëmundjes kërkon shmangien e udhëtimeve të kandidates nga Vlora në Tiranë, kohë efektive që ajo mund ta shfrytëzojë për të qenë pranë fëmijës. Nga ana tjetër në këtë gjykatë ekzistojnë kushtet për zhvillimin e praktikës në drejtim të infrastrukturës, larmisë së çështjeve, si dhe disponueshmërisë së gjyqtarëve të kësaj gjykate për të qenë gjyqtarë udhëheqës, pasi ka gjyqtarë që janë gjyqtarë të trupës së gjyqtarëve udhëheqës për këtë periudhë.

Ndërkohë që për kërkesat e kandidatëve {...} dhe {...}, Komisioni ka vlerësuar se vetëm përbërja e tyre familjare, nuk përbën rrethanë objektive të mjaftueshme për t'i caktuar në mentorim në gjykata pranë vendbanimit, në kushtet kur ata janë akoma studentë të Shkollës së Magjistraturës dhe në të njëjtën përbërje familjare kanë ndjekur edhe dy vitet e tjera të kësaj shkolle, pavarësisht se vendbanimi i tyre ndodhet në Fier.

Sa i përket caktimit të kandidatëve pranë gjyqtarëve udhëheqës për të kryer praktikën profesionale, rezulton se për gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pesë raste pranë të njëjtit gjyqtar janë caktuar dy kandidatë për gjyqtarë. Caktimi i më shumë se një kandidati pranë të njëjtit gjyqtar është i kushtëzuar nga shkaqet e mëposhtme:

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në të cilën do të kryejnë praktikën profesionale të gjithë kandidatët për gjyqtarë, të ndarë në tre periudha 4-mujore, ushtrojnë aktualisht detyrën 9 (nëntë) gjyqtarë të cilët janë të përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës, (kanë qenë edhe dy gjyqtarët, por dy gjyqtarët e tjerë u caktuan në skemën e delegimit në apelin administrativ) ndërkohë që numri i kandidatëve është 32 (tridhjetë e dy) dhe të ndarë sipas periudhave rezulton se për secilën periudhë duhet të atashohen pranë 9 (nëntë) gjyqtarëve përkatësisht 11, 11 dhe 10 kandidatë.

Për këto arsye, në periudha përkatëse 4-mujore, pranë pesë gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë do të atashohen për të kryer praktikën profesionale nga dy kandidatë. Përcaktimi i gjyqtarëve pranë të cilëve do të atashohen më shumë se një kandidat për magjistrat është bërë duke konsideruar (i) përvojën e tyre si gjyqtarë udhëheqës, (ii) pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me mentorimin dhe (iii) eksperiencën e tyre profesionale.

Për këto arsye, në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar caktimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë si gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2023-2024;

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar caktimi i gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2023-2024, sipas listës bashkëngjitur këtij projektvendimi, duke konsideruar gatishmërinë e shprehur prej tyre pas thirrjes që i është drejtuar nga Këshilli, plotësimin e kushteve ligjore si dhe detyrimin për ndjekjen e programit trajnues, si dhe përvojën e tyre profesionale;

Në pikën 3 të këtij projektvendimi është përcaktuar se magjistrati udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat për gjyqtar, sipas kritereve dhe treguesve të përcaktuar nga ligji, referuar formatit standard të miratuar nga Këshilli.

Në pikën 4 parashikohet se magjistrati udhëheqës përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit për ndarjen e çështjeve në gjykatën pranë të cilës ushtron funksionin (janë parashikime ligjore që ne i kemi reflektuar në projekt-akt, sikundër edhe më herët);

Në pikën 5 është parashikuar shtesa e pagës mujore të magjistratit udhëheqës;

Në pikën e 6 e drejta e kandidatëve për magjistratë për pushime vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat 15 ditë merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës;

Në pikën 7 parashikohet njoftimi i tij Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përfshirjen e gjyqtarëve udhëheqës në programin e trajtimit, si dhe njoftimi i gjyqtarëve udhëheqës dhe gjykatave në të cilat ata ushtrojnë funksionin;

Si dhe momenti i hyrjes në fuqi, duke qenë se jemi në një akt kolektiv në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, referuar parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

E mendoni të nevojshme që të lexoj tabelat me gjyqtarët?

(Nuk është e nevojshme leximi i tabelës.)

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtruan.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës

profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2023-2024”.

Bazuar në bazën ligjore përkatëse, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

1. Të caktojë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë si gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2023-2024.

2. Të caktojë gjyqtarët udhëheqës, për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024, sipas listës bashkëngjitur.

3. Gjyqtari udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magistrat, profili gjyqtar, sipas formularëve të miratuar, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në ligj.

4. Gjyqtari udhëheqës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit, për ndarjen e çështjeve në gjykatën pranë të cilës ushtron funksionin.

5. Gjyqtari udhëheqës, përgjatë periudhës përkatëse që ushtron këtë veprimtari, përfiton 5 % shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare të tij.

6. Gjatë praktikës profesionale, kandidati për magistrat, profili gjyqtar, gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magistratin udhëheqës. Kryetari i gjykatës jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me gjyqtarin udhëheqës të tij.

7. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe gjyqtarëve udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Relacioni aktual ka lidhje me renditjen në lidhje me kandidatët që kanë kandiduar për pozicionin e hapur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 që i përket procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Për këtë pozicion kanë kandiduar më parë zonja {...} (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër), z. {...} (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë), z. {...} (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër) dhe znj. {...} (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat).

Me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, nga ana e Këshillit u miratua lista e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale dhe për efekt të zbatimit të këtij vendimi, i vetmi kandidat për këtë pozicion ishte zoti {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Në lidhje me të, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, nga ana e Këshillit u vendos: Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve formale në lidhje me këtë kandidim. Ndërkohë që nga zoti {...} u paraqit dorëheqje nga kandidimi për këtë pozicion të lirë dhe në respekt të vullnetit të tij me vendimin nr.317, datë 14.06.2023, nga ana e Këshillit u vendos: “...Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}...”.

Ndërkohë që me vendimin nr. 342, datë 27.06.2023 nga ana e Këshillit u vendos: “Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21...”

Nga ana e relatorit u administruan aktet të cilat do të provonin përvojën profesionale minimale, mospasjen e masës disiplinore në fuqi, mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe në përfundim, për secilin nga kandidatët për këtë pozicion u mor me vendime të veçanta të cilët konsistojnë në kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele.

Konkretisht për zonjën {...} u mor vendimi nr. 386, datë 17.07.2023; për zotën {...} vendimi nr. 387, datë 17.07.2023; për zonjën {...} vendimi nr. 388, datë 17.07.2023.

Në kushtet kur më parë është vendosur relatori, me vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 filluan procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë të

shpallur me vendimin e tij nr. 21 datë 18.01.2023. Për kryerjen e renditjes u referua në mënyrë të detajuar seksionit Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020.

Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: “Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320/2020, relatori ka administruar aktet e nevojshme të ndodhura në dosjet e tyre personale dhe kështu konkretisht: në lidhje me vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës për kandidatët u administruan:

Kandidatja znj. {...} është e diplomuar në vitin akademik 2018–2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 – qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4165.96 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Kandidati z. {...} i diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 – qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Mirë”, me një total prej 3923.19 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 – qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4077.04 pikësh, nga 4450 të mundshme.

Për më tej, relatori u mbështet në pikat 8, 9, 12, të nenit 43 të ligjit “Për statusin” dhe në këtë kuadër, për renditjen e kandidatëve u ndoq hapi i vetëm i renditjes ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin Ç.1, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.

Siç u parashtrua, edhe më sipër, sipas për caktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të Vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”.

Duke iu referuar kësaj dispozite dhe kriterit të renditjes pra sipas “renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës”, për kandidatët u konstatua si më poshtë:

Për znj. {...} – Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 – Qershor 2019, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për z. {...} – Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 – Qershor 2019, kandidati është vlerësuar “Mirë”.

Për kandidaten znj. {...} – Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3-vjeçare Tetor 2016 – Qershor 2019, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “renditjes së të diplomuarve”, rezultoi që kandidatja znj. {...} dhe kandidatja znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “Shumë mirë” në renditje. Kurse kandidati z. {...} e ka nivelin e vlerësimit “Mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, identifikohen dy candidate me rezultate të më të larta pra znj. {...} dhe znj. {...}.

Më tej u vijua me përparësitë e parashikuara nga pika 103 ku nuk rezulton që ndonjë prej candidateve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.

Për rrjedhojë u kalua në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: “Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.”

Nga lista kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21/2023, rezulton se ato i përkasin dy viteve akademikë të ndryshëm në diplomim nga Shkolla e Magjistraturës. Dy kandidatët gjenden, konkretisht: znj. {...} në listën e Klasifikimit të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2019 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës; znj. {...} Klasifikimit të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në qershor 2020 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës. Qenia në vite akademikë të ndryshëm nuk përbën pengesë ligjore për renditjen e tyre në pozicionin ku kandidojnë.

Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2019 dhe qershor 2020 ka rezultuar se: i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4168.96 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.61 % të pikëve totale; ii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4077.04 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.62 %, të pikëve totale.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 21, datë 18.01.2023, ku siç rezulton bazuar në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme, znj. {...} është vlerësuar më lart, pra me 93.61 % të pikëve të mundshme, ndërsa znj. {...} është vlerësuar me 91.62 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja përfundimtare e kandidatëve për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, rezulton:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};

Përfundimisht nga ana e relatorit ju propozohet miratimi i këtij projekti, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...}.

3. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Jam dakord me konkluzionin që zonja {...} duhet të klasifikohet e para në renditje, krahasuar me kandidatët e tjerë. Ajo që unë kam në diskutim, duke qenë se sot është hera e parë që rendisim kandidatë të cilët nuk kanë asnjë vlerësim dhe renditen sipas pikëve të shkollës, më tërhoqi vëmendjen në relacion që janë zbatuar disa kriterë të tjera renditjeje veç pikëve të shkollës, pra është parë edhe niveli i vlerësimit (“shumë mirë”, “shumë mirë” dhe në qoftë se janë “shumë mirë”, “shumë mirë”, kjo përkthehet automatikisht në pikë, sepse nëse ka “shumë mirë” dhe “mirë”, detyrimisht ai që ka “shumë mirë” i ka pikët më të larta sipas shkollës). Por ajo që më bëri përshtypje është përvoja si i komanduar?! Pra diku ishte thënë në relacion që asnjëra nga këto nuk ka përvojë si e komanduar. Nëse do të kishte ndonjëra nga këto dy gjyqtare përvojën si e komanduar, do të zbatoheshin kriter preferencial renditjeje, pavarësisht se do të kishte pikë më të ulëta?

Alban Toro: Përvoja e komandimit është vlerë e shtuar. Duhet të merret në konsideratë ajo. Ne i kemi dhënë fuqi prapavepruese komandimeve të bëra...

Brikena Ukperaj: Një sekondë, se kjo ka shumë rëndësi për ta diskutuar.

Në qoftë se ne do ta miratojmë si kriter renditjeje komandimin përparësi, kur gjyqtarët s’kanë asnjë vlerësim, atëherë e kemi mbajtur standardin. Më tërhoqi vëmendjen mënyra e arsytimit Alban.

Alban Toro: Kemi mbajtur standardin që i kemi dhënë fuqi prapavepruese (i ndërpritet fjala).

Brikena Ukperaj: Tani të lutem, mos të hapim diskutime për gjëra që nuk i kemi sot në diskutim. Pra sot ne kemi për diskutim për të renditur gjyqtarë që nuk kanë asnjë vlerësim. Ligji thotë, neni 43, pika 8, me sa mbaj mend edhe në rregullore nuk e kemi përcaktuar përparësi në renditje të gjyqtarëve që nuk kanë asnjë vlerësim. Neni 43, pika 8, thotë: “Renditen duke u bazuar njëkohësisht në rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional, pra që është “shumë mirë” apo “mirë” nga shkolla dhe në renditje në listën e të diplomuarve ose në vlerësimin profesional të riemëruar sipas nenit 36.”, dhe më pas ke “sipas pikëve të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”.

Në qoftë se ne sot do kishim... {...} ka qenë e transferuar, nuk ka qenë e komanduar. Ideja është, do ta zbatojmë komandimin si kriter përparësie në rastin kur...? E ka thënë Albani, e ka thënë në relacion dhe ka thënë që këto të dy kanë vlerësime “shumë mirë” nga shkolla, kanë edhe këto pikë. Ka thënë, duke qenë se asnjë nga këto nuk ka... (e ndërpret mendimin). Ta mbaroj diskutimin, Alban dhe Ridvan.

Ideja është, që në vlerësimin tim, qenia si i komanduar, skemë delegimi apo çdo përparësi tjetër që ligji parashikon për gjyqtarët që kanë dy vlerësime apo për një vlerësim, nuk zbatohet në rastin e gjyqtarëve që renditen sipas pikëve, sepse në mënyrë të shprehur të thotë nëse gjyqtari nuk ka asnjë vlerësim, do ta rendisë sipas pikëve që ka marrë shkolla. Nuk mund të fusim këtu përparësi komandimin, skemën e delegimit apo çdo përparësi tjetër që njih ligji. Kjo mendoj që është esenciale për ta ndarë. Ose nuk do ta shkruaj fare në relacion dhe do themi që në këtë rast ka më shumë pikë dhe është automatikisht. Se as në rregullore nuk e kemi.

Marçela Shehu: Mund të them diçka të lutem?

Ajo që unë kuptoj, sot po kërkohet të diskutohet mbi standardin. Siç kërkova unë më duket në një rast, që kërkova të diskutohej dhe të votohej mbi standardin, dhe Këshilli tha jo, standardin do ta vendosim në rastin konkret. Prandaj, meqenëse sot asnjë nga këta të tre kandidatë nuk ka qenë i komanduar dhe ai kriter nuk na hyn në vlerësim, unë mendoj që standardin le ta mbajmë në një rast tjetër kur mund të ketë një kandidat që ka qenë i komanduar.

Brikena Ukperaj: Pse e mendova unë të rëndësishme?

Ky vendimi do zbardhet/do shkruhet dhe i njoftohet gjyqtarëve dhe kur i njoftohet, Këshilli duhet ta ketë të mirë përcaktuar se cilat janë kriteret e renditjes së gjyqtarëve të cilët nuk kanë asnjë vlerësim. Nuk mund të themi ne kështu, dhe kur të kemi standardin... Do ta shkruajmë ne vendimin. Ose do detyrohemi pastaj që në varësi të të shkruarit të vendimit unë do dal me një mendim paralel. Prandaj e ngrita si diskutim. Dhe është e mira që këto diskutime të ngrihen atëherë kur nuk ka emra kandidatësh konkretë. Dhe prandaj e mendoj.

Alban Toro: T'i jap fund debatit unë.

Unë aty kam cituar një dispozitë përkatëse, përpos asaj, është neni 103/a i rregullores tonë që bën përzgjedhjen. Por edhe fakti që ne i japim komandimit apo skemës së delegimit vlerë të shtuar edhe kur s'kanë ekzistuar në ligjin e kohës, e bën standardin akoma më të zbatueshëm në rastin konkret. Megjithatë po i referohemi parashikimit specifik që ka bërë rregullorja jonë që thotë: "102. Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart. 103. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme: a) "përvoja si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit" - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;"

Rregulloren pra, atë po lexoj. Kërkova rregulloren, ma sollën. E kemi shpikur ne, e kemi përfshirë siç e kemi përfshirë edhe kur s'ka qenë përfshirë.

Brikena Ukperaj: Mund të kem kohë zoti Zëvendëskryetar, të shikoj rregulloren?

Ilir Rusi: Patjetër!

Atëherë, zonja Ukperaj kërkon kohë të konsultohet me rregulloren për çështjen që ka në diskutim dhe ndërpresim pak mbledhjen.

(25 minuta pushim, ndërkohë që anëtarët konsultohen me vendimin përkatës.)

Ilir Rusi: Viojmë mbledhjen e ditës së sotme atje ku e ndërpreme, duke ia dhënë fjalën zonzjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Pasi u konsultova edhe me rregulloren e miratuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedurat e lëvizjeve paralele, mendoj që përparësitë e parashikuara në rregullore zbatohen vetëm në rastet kur dy kandidatët janë të vlerësuar me pikë të njëjta nga ana e Shkollës së Magjistraturës, sepse edhe rregullorja parashikon në mënyrë të shprehur që: “102. Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin *(por nuk është ky rasti)*. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”

Duke qenë se rregullorja e parashikon dhe ky është parashikim që është motamo sipas ligjit, kur bëhet fjalë për rezultatet e renditjes, bëhet fjalë për pikë, jo për nivele “shumë mirë”, “shkëlqyeshëm” apo “mirë”. Sepse ky është edhe interpretimi që vjen konform ligjit. Në kushtet kur kemi dy kandidatë që kanë rezultate të ndryshme, automatikisht ai që ka pikët më të larta kualifikohet. Përparësitë e parashikuara në rregullore, në vlerësimin tim, gjejnë zbatim vetëm në rastin kur kandidatët kanë pikë të njëjta, jo kur kandidatët kanë pikë të ndryshme. Kur kanë pikë të njëjta atëherë mund të shkohet tek përparësia. Nëse nuk zbatohet dhe përparësia, pastaj janë edhe kriteret e tjera.

Kështu e kam mendimin në zbatim të rregullores dhe ligjit.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Toro!

Alban Toro: Aktualisht mendoj që është interpretim i gabuar i dispozitës së parashikuar nga akti normativ. Vetë akti ka parashikuar që ai të bëhet i ndarë, pra duke futur ndërmjetëm edhe përparësinë, pra mbasi verifikohet rezultati i njëjtë për secilin

91

kandidat i cili është në nivel vlerësimi (vlerësim në nivele “shumë mirë”, “mirë”, “shkëlqyeshëm”), përfshihet si pjesë vlerësuese apo përvojë e shtuar është komandimi apo skema e delegimit. Më pas ai e detajon akoma edhe më shumë kur në pikën e pestë ai përfshin si fitues mbasi vlerësohen pikët, pra e fillon me vlerësimin “mirë”, “shumë mirë”, përfshin ndërmjet pjesën e skemës së delegimit dhe të komandimit dhe në përfundim, për të krijuar apo identifikuar kandidatin më të mirë ai thotë: “105. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë...”. Pra në këtë rregullore kemi parashikuar të bëjmë identifikimin e kandidatit duke marrë për bazë të tre kriteret vlerësuese (vlerësimi me nivel, përparësinë që i jep vlera e shtuar e komandimit apo e delegimit dhe më pas kur janë të dy përsëri njësoj, zbresim tek pikët).

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët e tjerë?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro, por ndaj qëndrim të ndryshëm në arsyetim, të cilin do ta parashtroj në mendim paralel.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Znj. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Këshilli me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime/ 1 vlerësim/ pa vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë. Në këtë listë janë përfshirë gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë.

Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 është vendosur: “I. Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 249 dhe 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim. Më tej fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.”

Pas procedurës së shortit në këtë vendim është përcaktuar edhe relatori përkatës.

Mbas përfundimit të procedurave të verifikimit, deri më sot, Këshilli ka vendosur kualifikimin e 3 (tre) kandidatëve dhe vijimin për ata të procedurave të lëvizjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në lidhje me kandidatët që janë kualifikuar për lëvizjen paralele, janë si më poshtë:

Zoti {...}, kandidon për pozicionet nr. 248 dhe nr. 251.

Zoti {...}, kandidon për pozicionin nr. 250.

Zonja {...}, kandidon për pozicionet nr. 248 dhe nr. 253.

Sa i përket pozicioneve, tabloja me gjyqtarët e kualifikuar është si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 248 janë të kualifikuar z. {...} dhe znj.

{...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 250 është i kualifikuar {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 251 është i kualifikuar z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 253 është e kualifikuar znj. {...}.

Sa më sipër, rezulton që në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të ketë kandidatë të kualifikuar për

transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, ku shumica e të cilëve kanë kandiduar për tre pozicione të lira, në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji, pika 5, e nenit 43 të Ligjit për Statusin.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele.

Lidhur me këtë, sipas projektvendimit, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë 4 pozicione të lira, është propozuar që të ketë një relator për katër pozicionet e lirë të lira të shpallura, ku garojnë kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

Sa i përket relatorit për këto procedura përzgjedhjeje të lëvizjes paralele, ai duhet të zgjidhen me short ndërmjet 3 (tre) anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme; në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për 4 pozicionet përkatëse.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit, pas zhvillimit të shortit, për këto procedura përzgjedhjeje sipas pozicioneve përkatëse.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua deri tani?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, nga administrata të vazhdohet me përgatitjen dhe hedhjen e shortit përkatës.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Dritan Hallunaj, z. Alban Toro dhe z. Klodian Kurushi.

Pas përzgjedhjes, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023, relator përzgjidhet z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka ndonjë diskutim për hedhjen e shortit.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës duke përfshirë edhe propozimin për relatorin e nxjerrë nëpërmjet shortit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për

pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për këto procedura përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele sipas numrit të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:

a) Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet 248, 250, 251 dhe 253, datë 24.05.2023 – relator z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikëna Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
5. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Zhvillimit të Karrierës, i përditësuar ky. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Merr fjalën **zoti Kurushi** për të parashtruar relacionin “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”. Ndër të tjera, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka paraqitur kërkesë për një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion. Trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}; Gjyqtarja {...} ka caktuar masë sigurimi ndaj të pandehurit;

gjqtare {...}, ka gjykuar kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim. Z. {...} është përjashtuar nga shorti sipas urdhrit 136, datë 21.02.2023.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Ndaj propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konkretisht: z. Artan Hajredinaj.

(Në këtë moment të mbledhjes, anëtarët njihen me faktin se për shkak të shkëputjes së energjisë elektrike, sistemi elektronik në të cilin zhvillohen procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera, nuk funksionon.)

Ilir Rusi: Ju njoftojmë se shorti hidhet në mënyrë elektronike dhe për shkak të shkëputjes së energjisë elektrike, atëherë sistemi do një kohë të arsyeshme për t’u rivënë në funksionim.

Kështu që po vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, sikundër edhe u vendos në fillim të kësaj mbledhjeje.

(Pas këtij momenti, për ekonomizim të kohës, deri në momentin e rilidhjes së sistemit elektronik për hedhjen e shortit si më sipër, trajtohet çështja 13 e cila u shtua

në fillim të mbledhjes, dhe që ka për objekt miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë (për më shumë shih procesverbalin e pikës 13 shtesë); si dhe pas saj edhe çështja e fundit në rendin e ditës që ka për objekt kualifikimin/skualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022, çështje e cila trajtohet vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit. Ndërkohë, theksohet për procesverbalin që në trajtimin e çështjes me dyer të mbyllura largohet zonja Ukperaj dhe nuk merr pjesë më në vijimin e mbledhjes, si dhe futet në sallën e mbledhjes anëtarja e Këshillit znj. Fatmira Luli. Pas trajtimit të këtyre dy çështjeve, mundësohet lidhja nëpërmjet platformës “Teams” si dhe vijon shqyrtimi i çështjes së lënë përgjysmë.)

Të pranishëm në vijimin e trajtimit të çështjes:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Irena Plaku** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Marçela Shehu** (anëtare)
9. **Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Shënim 2: Anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli***, futet në sallën e mbledhjes në trajtimin e çështjes me dyer të mbyllura, ndaj është prezent në mbledhje gjatë rilidhjes në platformë dhe vijimit të trajtimit të kësaj çështjeje.

Shënim 3: Anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Brikena Ukperaj*** largohet në trajtimin e çështjes me dyer të mbyllura dhe nuk ndodhet prezent në mbledhje gjatë rilidhjes në platformë dhe vijimit të trajtimit të kësaj çështjeje.

Ilir Rusi: Në vijim të trajtimit çështjeve të përcaktuara dhe të shtuara në mbledhjen e ditës së sotme, po vazhdojmë mbledhjen me dyer të hapura, me komunikim edhe me të tretët, dhe për shkak të një defekti teknik, nga relatimi i zotit Kurushi, ishim në fazën e hedhjes së shortit nga administrata në lidhje me çështjet e prezantuara për Gjykatën e Kukësit. Kështu që do i jepja fjalën zotit Kurushi.

Në lidhje me çështjen e parë relatimi u bë i plotë nga zoti Kurushi pak më herët, ndaj procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 621), gjyqtari Besmir Stroka.

Vijohet parashtrimi mbi relacionin “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”. Ndër të tjera, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka paraqitur kërkesë për katër çështje penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion. Në çështjen e parë gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake; Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë gjykuar bashkëpandehurit. Në çështjen e dytë trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i seancës paraprake; Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake. Në çështjen e tretë trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i seancës paraprake; Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake. Në çështjen e katërt trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Gjyqtarit {...} i është pranuar kërkesa për heqje dorë; Gjyqtari {...} ka qenë gjyqtar i hetimeve paraprake.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Ndaj propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 4 (katër).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konkretisht: z. Artan Hajredinaj.

Merr fjalën zoti Rusi për të theksuar faktin që në trajtimin e kësaj çështjeje u largua zonja Ukperaj për arsye shëndetësore. Ndërkohë që prezent në trajtimin e kësaj çështjeje është zonja Luli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale (kërkesa nr. 132/572), gjyqtari Sokol Pasho.

Për çështjen nr. 2, penale (kërkesa nr. 3), gjyqtarja Migena Laska.

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 350), gjyqtarët Besnik Hoxha relator, Enkeleida Dalipi dhe Sokol Pasho (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale (kërkesa nr. 114), gjyqtarja Migena Laska.

Me trajtimin e kësaj çështjeje mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.07.2023)

Pika 13 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). *(shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 27.06.2023 dhe 19.07.2023.)*

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:14 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

13 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (*shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 27.06.2023 dhe 19.07.2023.*)

Ilir Rusi: Kështu që po vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, sikundër edhe u vendos në fillim të kësaj mbledhjeje, me propozim të zonjës Shehu dhe me votim në këtë mbledhje u vendos që të përfshihet në rendin e ditës dhe shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, për të cilin u relatua në mbledhjen e datës 19.07.2023 nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, konkretisht nga relator z. Kurushi, një draft në lidhje me “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”. Ndërkohë po në atë mbledhje, të datës 19.07.2023, nga zonja Ukperaj u paraqit një projekt tjetër në lidhje me këtë çështje, me emërtim: “Për miratimin e rregullave për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”. Pas prezantimit të këtij materiali, nga zonja Shehu, në

mbledhjen e datës 19.07.2023 u kërkua kohë për t'u njohur me përmbajtjen e këtij materiali të paraqitur rishtazi në atë mbledhje nga zonja Ukperaj.

Po me propozim të zonjës Shehu, sot u propozua përfshirja në rendin e ditës të kësaj çështjeje, e cila me një votim me shumicë u vendos të përfshihet.

Në vijim të diskutimeve kërkohet fjala nga zonja Plaku për vijimin më tej të trajtimit të kësaj çështjeje.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, siç e thashë në fakt edhe kur votova, unë nuk jam përgatitur për këtë relacion sot për shkak se kemi pasur dy mbledhje, si ditën e djeshme dhe të sotme, dhe seanca e mëparshme u shty për t'u njohur dhe nuk u diskutuan të dy projektet në fakt. Unë do kisha dashur që të ishim njoftuar që ditën e djeshme, për t'u njohur me materialet, aq më tepër kur materialet sapo na u vunë në dispozicion. Unë kam pasur ngarkesë për t'u njohur me aktet e tjera dhe nuk kam qenë në mundësi për t'u njohur/përgatitur me këtë relacion dhe për të pasur pastaj mundësi për të diskutuar lidhur me të.

Kështu që unë do kërkoj kohë për t'u njohur me dy aktet.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Sipas standardit të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në këto raste kur kërkohet kohë për t'u njohur me aktin, qoftë edhe nga një anëtar i vetëm, atëherë procedohet me shtyrjen e trajtimit të kësaj çështjeje në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Marçela Shehu: Më fal, vetëm një sqarim.

Besoj u kuptua, por doja unë ta theksoja që unë nuk paraqita ndonjë akt të ri me disa ndryshime. Sigurisht mund të ishin pjesë e diskutimeve, por nuk paraqita një akt të ri. Ishin dy aktet që janë vënë në dispozicion më përpara, jo sot. Por që gjithsesi është e drejta juaj për t'u shprehur.

Irena Plaku: Atëherë, patjetër që janë dy akte që janë paraqitur në seancën e mëparshme, ku të paktën akti që paraqiti zonja Lubonja u depozitua në atë seancë dhe

ju direkt kërkuat kohë për t'u njohur dhe u shty normalisht. Nuk është se e kam lexuar atë ditë normalisht, të dyja aktet, duke qenë se do njoftoheshim paraprakisht dhe do kisha mundësi të përgatitesha. Domethënë nuk u shtruan për diskutim.

Të paktën dje pasdite të ishim njohur me këtë propozim ose të ishte shtyrë për ditën e nesërme, do isha dakord që ta diskutoja. Por sot u vu në mbledhje plenare, të cilën e thashë që në fillim që nuk jam përgatitur, dhe prandaj kërkoj kohë që të njihem dhe të përgatitem me të dyja materialet. Domethënë u shty seancën e mëparshme pa u diskutuar fare. Thjesht u paraqit një propozim, i cili siç edhe ju vetë nuk e kishit lexuar, edhe unë nuk e kisha lexuar. Prandaj.

Marçela Shehu: Pra ajo mbledhje nuk u shty vetëm me kërkesën time, por paskeni qenë edhe ju e panjohur. Doja të theksoja vetëm këtë që unë nuk kisha materiale të reja sot për t'u diskutuar.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Atëherë sipas praktikës, po e theksoj edhe një herë, kjo çështje do të shtyhet për t'u trajtuar në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke marrë në konsideratë tematikën e çështjes që është në vijim të këtij rendi dite, do të vazhdojë mbledhja me dyer të mbyllura për shkak të tematikës së çështjes. Ndërkohë që pas trajtimit të kësaj çështjeje do të rilidhemi përsëri për të vazhduar me trajtimin e pikës 12 e cila u ndërpre për shkak të një defekti teknik në lidhje me ndërprerjen e energjisë elektrike.

* * *

(Pika 13 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor